

**AKTI I THEMELIMIT  
PER THEMELIMIN E SHOQERISE ANONIME**

**“TOP-OIL” SHA**

**Neni 1**

**AKSIONERET**

Aksioneret e shoqerise “TOP-OIL” sha jane ;

Luan Saraçi, i biri i Zeqirit dhe i Xharies, i dtl. 14 shtator 1963, lindur ne Peshkopi e banues ne Tirane, rruga “Kavajes”, Pall.Spead, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar ;

Nimet Saraçi, i biri i Zeqirit dhe i Xharies, i dtl. 29 korrik 1957, lindur ne Peshkopi e banues ne Tirane, rruga “Kavajes”, Pall.Spead, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar ;

**NENI 2  
EMERTIMI**

Emertimi i shoqerise do te jete “TOP-OIL” sha.

**NENI 3  
SELIA**

Shoqeria e ka seline ne Peshkopi, lagja “Vehbi Dibra”.

**NENI 4  
KAPITALI**

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 2.000.000 (dy million) leke dhe i ndare si me poshte :

1. Luan Saraçi zoteron 50 % te kapitalit themeltar.
2. Nimet Saraçi zoteron 50 % te kapitalit themeltar.

**NENI 5  
OBJEKTI**

Ne fushen e tregtimit import-eksporti, me shumice dhe pakice te karburanteve dhe vajrave lubrifikante, te naftes e derivatet e saj, prodhimin e perpunimin e tyre, pjese kembimi per automjete dhe sherbimi e riparimi i tyre, pika servisi e tregtim te mallrave industriale e ushqimore, tregtim te tyre me shumice e pakice,fruta perime, hidrosanitare, mobiljeve,artikujve kozmetike, artistike, lendeve te perpunuara e te paperpunuara, te bimeve medicinale, duraluminit, lendes drusore, plastike, prodhime e tregtim te materialeve te ndertimit, shfrytezim pyjesh,hapjen e bar bufeve, restoranteve, pikave te autoservisit, lavazhit, pjese kembimi, hotele, fshatrave turistike, moteleve si dhe agjensive per shitblerje,dhenie me qira te pasurive te tundshme dhe te patundshme, agjensive komisionere , transport te udhetareve e te mallrave si brenda vendit ashtu dhe jashte tij.

Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje cdo operacion tregtar e financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Shoqeria mund te hape edhe veprimtari te reja, te krijoje ose te marre pjese ne sipermarrje te tjera, si brenda ashtu edhe jashte vendit, pa cenuar objektin kryesor te shoqerise.

#### NENI 6 KOHEZGJATJA

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe te pakufizuar duke filluar nga data e marrjes se vendimit per regjistrimin e saj ne Gjykate.

#### NENI 7 STRUKTURA

Shoqeria do te kete organet e saj qe jane :

1. Asambleja e aksionereve.
2. Keshilli Mbikqyres.
3. Drejtoria (Drejtori i Pergjithshem)

Rregullat e funksionimit te tyre parashikohen ne Statutin e Shoqerise dhe pranohen nga aksioneret.

Kryetar i Keshillit Mbikqyres eshte z. Ludi Saraçi.

Anetar z. Argent Saraçi.

Anetar z. Argisa Saraçi.

#### NENI 8 Akti i themelimit

Hartimi i aktit te themelimit behet ne 5 (pese) ekzemplare origjinale, ne gjuhen shqipe dhe me vlere te barabarte.



NENI 9  
Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Organi i zgjidhjeve te mosmarreveshjeve kur ato nuk zgjidhen me mirekuptim do te jete Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

NENI 10

Hyrja ne fuqi

Ky akt themelimi qe aksioneri i vetem e ka bere me vullnetin e tij te lire dhe te plote do e hyje ne fuqi sot ne ditën e nenshkrimit te saj me 20.02.2004.


AKSIONERET  
LUAN SARAÇI NIMET SARAÇI

REPUBLICA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE

Nr. 662 Rep.  
Nr. 58 Kol.

VERTETIM

Vertetohet se me date 20.02.2004 para meje noteres u paraqit kerkuesit LUAN SARAÇI dhe NIMET SARAÇI per identitetin e te cileve u sigurova nga leternjoftimi perkates, madhore , me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet deklaruan se akti i mesiperm eshte bere me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe nenshkruan para meje noteres dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.



# STATUTI

## I SHOQERISE ANONIME

### TOP-OIL SHA

Shoqeria anonime pa oferte publike  
Kapitali themeltar 2.000.000 leke  
Selia : Peshkopi, lagja "Vehbi Dibra"

Ne mbeshtetje te ligjit 7638, date 19.12.1992 "Per shoqerite Tregtare" si dhe ligjit 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te" i nenshkruari nga aksioneret ;

Luan Saraçi, i biri i Zeqirit dhe i Xharies, i dtl. 14 shtator 1963, lindur ne Peshkopi e banues ne Tirane, rruga "Kavajes", Pall.Spead, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar ;

Nimet Saraçi, i biri i Zeqirit dhe i Xharies, i dtl. 29 korrik 1957, lindur ne Peshkopi e banues ne Tirane, rruga "Kavajes", Pall.Spead, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar ;

Kane hartuar Statutin qe vijon te shoqerise anonime pa oferte publike e emertuar TOP-OIL SHA si me poshte ;

#### NENI 1 FORMA

Me personat pronar te aksioneve te krijuara sic tregohen me lart te te dy aksionereve qe jane pronar ne menyre te barabarta te te gjitha aksioneve krijohet nje shoqeri anonime qe rregullohet nga ligjet ne fuqi dhe nga ky statut.

#### NENI 2 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria ka kete objekt :

Ne fushen e tregtimit import-eksporti, me shumice dhe pakice te karburanteve dhe vajrave lubrifikante, te naftes e derivatet e saj, prodhimin e perpunimin e tyre, pjese kembimi per automjete dhe sherbimi e riparimi i tyre, pika servisi e tregtim te mallrave industriale e ushqimore, tregtim te tyre me shumice e pakice, fruta perime, hidrosanitare, mobiljeve, artikujve kozmetike, artistike, lendeve te perpunuara e te paperpunuara, te bimeve



medicinale, duraluminit, lendes drusore, plastike, prodhime e tregtim te materialeve te ndertimit, shfrytezim pyjesh, hapjen e bar bufeve, restoranteve, pikave te autoservisit, lavazhit, pjese kembimi, hotele, fshatrave turistike, moteleve si dhe agjensive per shitblerje, dhenie me qira te pasurive te tundshme dhe te patundshme, agjensive komisionere, transport te udhetareve e te mallrave si brenda vendit ashtu dhe jashte tij.

Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje cdo operacion tregtar e financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Shoqeria mund te hape edhe veprimtari te reja, te krijojë ose te marre pjese ne siper marrje te tjera, si brenda ashtu edhe jashte vendit, pa cenuar objektin kryesor te shoqerise.

### NENI 3

#### EMERTIMI

Emertimi i shoqerise eshte "TOP-OIL". Ne te gjitha aktet dhe dokumentet qe dalin nga shoqeria emertimi i saj do te ndiqet menjehere nga inicialet "SH.A." dhe nga shpallja e kapitalit themeltar te saj.

### NENI 4

#### VENDNDODHJA E SELISE

Selia e shoqerise eshte ne Peshkopi, lagja "Vehi Dibra".

Selia mund te transferohet ne cdo vend tjeter te Peshkopise ose kudo ne Territorin e Republikes se Shqiperise me nje vendim te thjeshte te Keshillit Mbikqyres, qe ratifikohet nga Asambleja e zakonshme me e afert e aksionereve.

### NENI 5

#### KOHEZGJATJA

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe te pakufizuar. Shkurtimi i kesaj kohezgjatjeje ne rastin e nje prishjeje te pershpejtuar te shoqerise behet me vendim te Aksionereve .

### NENI 6

#### KONTRIBUTET DHE KAPITALI THEMELTAR

Ne momentin e themelimit te shoqerise jane sjelle si kontribut ne para nje shume prej 2.000.000 leke, qe i pergjigjet vleres nominale te aksioneve e qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise. Keto aksione jane nenshkruar dhe shlyer teresisht nga te dy aksioneret:

1. Luan Saraçi zoteron 50 % te kapitalit themeltar.
2. Nimet Saraçi zoteron 50 % te kapitalit themeltar.



3.

Kapitali themeltar i shoqerise ne ditën e themelimit të saj, është 2 milion leke. Ky kapital është i ndarë në 2 mijë aksione, secili me një vlerë nominale 1000 (njemijë) leke.

#### NENI 7 ZMADHIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise mund të zmadhohet sipas modaliteteve dhe menyrave të parashikuara në nenet 150 deri 163 të ligjit "Për shoqerite tregtare".

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund të kryhet vetëm me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionereve.

Aksioneret kanë të drejtën e përparësise për nënshkrimin e aksioneve të shlyeshme në para që emetohen për zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejtë është në përpjestim me shumën e aksioneve të zotëruara nga secili aksioner përpara zmadhimin e kapitalit.

#### NENI 8 TRANSFERIMI DHE SHITJA E AKSIONEVE

Aksionet e shoqerise janë të transferueshme.

Transferimi i pronësise së aksioneve nominative bëhet mbasi të jete marrë miratimi me shkrim nga Këshilli Mbikqyres i shoqerise.

Përparasia në transferimin e aksioneve iu takon aksionereve të tjere të shoqerise, sipas radhës së paraqitjes së ofertave, të cilat vlerësohen nga Këshilli Mbikqyres.

Aksionet mund t'i transferohen cdo personi fizik e juridik, shqiptar ose i huaj. Këshilli Mbikqyres duhet t'i paraqitet një kerkese ku përcaktohet identiteti i personit që i transferohet pronësia, numri i aksioneve që parashikon transferimin e pronësise dhe cmimi i ofruar. Cmimi përfundimtar të shitjes së aksioneve e vendos Këshilli Mbikqyres, i cili mund të perdore edhe eksperte të autorizuar.

Por, në qofte se Këshilli Mbikqyres ka refuzuar shitjen e aksioneve një vlerësi jo aksioner, brenda të tete ditëve nga data e njoftimit të refuzimit shiteshi duhet t'i njoftojë shoqerise në se ka hequr dorë apo jo nga projekti i shitjes së aksioneve. Në rast se shiteshi nuk ka hequr dorë, atëherë Këshilli Mbikqyres duhet të bëjë që aksionet të blihen nga një ose disa persona të zgjedhur prej tij.



## NENI 9 TE DREJTAT DHE DETYRAT E LIDHURA ME AKSIONET

Cdo aksion i jep zoteruesit te tij te drejten e marrjes te nje pjese nga fitimet e shoqerise ne perpjestim me kuoten pjese te kapitalit qe ai perfaqeson.

Pronesia e nje aksioni permban te drejten e plote te aderimit ne Statutin e shoqerise dhe ne vendimet e aksionerit. Perverc ketyre, aksioni i jep zoteruesit te tij te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne Asamblene e Pergjithshme ne kushtet e parashikuara nga ligji ose te caktuara ne kete statut.

Aksioneret jane pergjegjes materialisht deri ne kufirin e vleres nominale te aksioneve qe zoterojne.

Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet e ndjekin ate ne cfaredo forme qe transferohet nga njera dore ne tjetren.

## NENI 10 DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Organi drejtues dhe administrues i shoqerise eshte :

Vendimet e aksionereve ose te themeluesve, mbledhjet e tyre te zakonshme dhe te jashtezakonshme.

Keshili Mbikqyres.


Drejtoria (Drejtoi i Pergjithshem)

Shoqeria mund te krijojte ne kushtet e parashikuara nga ligji e te percaktuara ne kete Statut edhe departamente, dege dhe perfaqesi te saj.

## NENI 11 RREGULLA TE PERBASHKETA PER MBLEDHJEN E AKSIONEVE

a) Natyra dhe karakteri i detyrueshem i vendimeve. Vendimet e aksionereve cilesohen te zakonshme ose te jashtezakonshme sipas natyres se vendimeve per te cilet ato jane thirrur qe te marrin. Cdo vendim perfaqeson teresine e aksionereve me te drejte vote.

b) Asambleja thirret nga Kryetari i keshillit Mbikqyres nga jo me pak se dy anetare te ketij Keshilli o se nga Drejtoria. Ne mungese te tyre ajo thirret nga eksperti kontabel i autorizuar ose nga nje ose disa aksionere qe se bashku zoterojne 1/10 e kapitalit themeltar.



Asamblete e pergjithshme mblidhen ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te treguar ne thirrjen qe i dergohet cdo aksioneri 15 dite perpara mbledhjes e qe permban rendin e dites.

c) Pjesemarrja e perfaqesimit ne Asamble.

Çdo aksioner ka te drejte te asistojë ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme dhe te marre pjese ne vendimet e saj, personalisht ose nepermjet nje perfaqesuesi te pajisur me mandat te posacem e ne kushtet e parashikuara nga ligji.

ç) Drejtimi i mbledhjes dhe procesverbalet.

Mbledhjet e Asamblese drejtohen nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres ose ne mungese te tij, nga anetar i Keshillit i caktuar nga kryetari . Drejtuesi i mbledhjes cakton edhe nje sekretar ( qe mund te jete aksioner ) per te mbajtur procesverbalin. Procesverbali pervec te tjerave permban edhe :

- daten dhe vendin e mbledhjes,
- numrin e aksionereve te pranishem dhe fuorumin e arritur,
- drejtuesin e mbledhjes,
- rendin e dites,
- dokumentat e raportet qe jane diskutuar,
- nje permbledhje te debateve,
- rezultatet e votimeve

Procesverbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e Shoqerise.

d) Forumi dhe votimi

Ne Asamblete e Pergjithshme quorumi llogaritet per teresine e aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise. E drejta e votes qe u perket aksionereve eshte perpjesetimore me kapitalin qe ato perfaqesojne. Çdo aksioner jep zoteruesit te drejten e nje vote. Votimi kryhet i vecante per cdo ceshtje apo vendim.


dh) Venia e dokumentave ne dispozicion te aksionereve

Shoqeria mban dh e ve ne dispozicion te aksionereve ne kushtet dhe afatet e parashikuara me ligj, dokumentat e llogarite vjetore qe shqyrton Asambleja.

## NENI 12

### ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ZAKONSHME

Asambleja e Pergjithshme e zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar. Ajo merr vendime





te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksionet e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne jo me pak se 50 % te aksioneve me te drejte vote.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votive qe zoterojne aksioneret e pranishem ose perfaqesuar. Vendimet e samblese se zakonshme mund te jene edhe qarkullues. Per te realizuar kete lloj vendimi shperndahet projekti, mblidhen verejtjet dhe me pas firmoset vendimi perfundimtar, pa u mbledhur aksioneret fizikisht ne ndonje salle.

Asambleja e pergjithshme e zakonshme merr cdo vendim qe nuk sjell ndryshimin e statutit te shoqerise. Ajo ka keto kompetenca :

- miraton politiken e pergjithshme ( strategjine afatgjate te zhvillimit te shoqerise)
- miraton plan-biznesin dhe planin financiar vjetor.
- Miraton, n dryshon ose hedh poshte llogarite vjetore qe jane shtruar per miratim,
- Vendos per shperndarjen e fitimit dhe destinimin e rezultatit ekonomik ne pajtim me ligjet dhe statutin,
- Emeron dhe shkarkon kryetarin dhe aneteret e Keshillit Mbikqyres (qe mund te quhet edhe Bord Drejtues), si dhe cakton shperblimet e prashikuara ne Statut per ta,
- Miraton ose jo emertimet e anetareve te keshillit Mbikqyres te bera nga vete ky keshill si emerime te perkohshme,
- Shkarkon me propozimin e Keshillit Mbikqyres, anetaret e Drejtorise (perfshire edhe drejtorin e pergjithshem),
- Miraton pjesemarrjen ne siper marrje te tjera, brenda ose jashte vendit,
- Ratifikon ose jo ndryshimin e selise se shoqerise,
- Emeron ekspertin (ose ekspertet kontabel) te autorizuar dhe vendos per raportin e paraqitur prej tyre lidhur me marreveshjet qe i nenshtrohen autorizimit paraprak te keshillit Mbikqyres.

### NENI 13

#### ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME

Asambleja e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare kur aksioneret e pranishem ne mbledhje zoterojne jo me pak se  $\frac{3}{4}$  e aksioneve me te drejte vote, kurse ne mbledhjen e dyte ky fuorum eshte jo me pak se  $\frac{1}{2}$  e aksioneve me te drejte vote.



Vendimet e Asamblese merren me shumicen prej  $\frac{3}{4}$  e votive qe u perkasin aksionereve te pranishem.

Asambleja e jashtezakonshme ka keto kompetenca:

- te ndryshoje statutin e shoqerise;
- te vendose zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit ne baze te procedurave te parashikuara ne ligj dhe raportit te paraqitur nga Keshilli Mbikqyres,
- te vendose per prishjen (ose shpermdarjen) e shoqerise ne rast te humbjeve te konstatuara, sipas kushteve dhe procedurave te parashikuara ne ligj.
- te heqe te drejten e perparemise se nenshkrimt te aksioneve, ne qoftese e cmon te arsyeshme ne rastin e zmadhimit te kapitalit;
- te ndryshoje kompetencat e Keshillit Mbikqyres dhe te Drejtorise (Drejtorit te Pergjithshem),
- mbledhjet e Asamblese se jashtezakonshme verbalizohen dhe materialet ruhen ne arkivin e shoqerise.

#### NENI 14 KESHILLI MBIKQYRES

Keshilli Mbikqyres zgjidhet nga Asambleja e zakonshme e shoqerise ne cdo 3 vjet. Ai perbehet nga tre anetare, njeri prej te cileve eshte Kryetar.  $\frac{1}{3}$  e anetareve te Keshillit Mbikqyres zgjidhen nga te punesuarit. Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga Asambleja e pergjithshme e zakonshme vetem per shkaqe te perligjura.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres te zgjedhur nga Asambleja jane persona fizike ose juridike, qe nuk duhet te jene te punesuar ne shoqeri. Ne rastin kur nje anetar i keshillit Mbikqyres eshte nje person juridik, ai duhet te caktoje nje perfaqesues te perhershem.

Nese nje ose disa vende te anetareve te Keshillit Mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekje, shkarkimi ose doreheqje, zevendesimi i tyre behet jo me vone se tre muja. Anetari i emeruar ne zevendesim te nje anetari tjeter, perfundon mandatin e paraardhesit.

Mbledhjet e keshillit Mbikqyres behen me thirrjen e Kryetarit sa here qe kerkon interesi i shoqerise dhe te pakten nje here ne tre muja. Mbledhjet mbahen ne seline e shoqerise dhe rendi i dites caktohet nga Kryetari.



Çdo anetar i Keshillit Mbikqyres mund t'i jape mandate nje anetari tjetër për ta përfaqësuar në një mbledhje të Keshillit.

Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres janë të vlefshme kur numri i anetareve të pranishëm në mbledhje është jo më pak se gjysma e anetareve në funksion.

Vendimet merren me shumicën e votave të anetareve të pranishëm dhe të përfaqësuar. Në rast votash të barabarta ajo e Kryetarit është përcaktuese. Në rastin e zgjedhjes ose shkarkimit të drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë kërkohet edhe vota e Kryetarit të keshillit Mbikqyres).

Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres evidentohen me procesverbale që nënshkruhen nga drejtuesi i mbledhjes dhe ruhen në arkivin e shoqërisë.

Vendimet e Keshillit Mbikqyres mund të jenë edhe qarkulluese. Për të realizuar këtë lloj vendimi, shpërndahet projekti, mbledhen verejtjet dhe më pas firmoset vendimi përfundimtar pa u mbledhur anëtarët fizikisht në ndonjë sallë.


Keshilli Mbikqyres ka vulën e vet.

Kryetari i Keshillit Mbikqyres të shoqërisë "TOP-OIL" është z. Ludi Saraçi, Anetar z. Argjent Saraçi dhe Argjisa Saraçi.

Anetari i tretë do të zgjidhet nga të punësuarit.

Keshilli Mbikqyres ka këto kompetenca ;

1. Ushtron kontrollin e përhershëm të drejtimit dhe administrimit të shoqërisë nga ana e administratës së saj.
2. miraton strukturën organizative të shoqërisë dhe ndryshimet e saj, krieteret e punësimit dhe të pagave, si dhe rregullohen e brendshme të shoqërisë,
3. autorizon dhenien e dorezanive dhe garancive,
4. autorizon kryerjen e investimeve të atyre të parashikuara në programin financiar vjetor,
5. autorizon hapjen e veprimtarisë ose degeve të reja, shkrirjen, bashkimin ose mbylljen (teresisht a pjesërisht) të veprimtarive dhe degeve të shoqërisë;
6. autorizon pjesëmarrjen në shoqëri të tjera;
7. autorizon shitjen dhe shkëmbimin e pasurive që përbejnë aktive të qendrueshëm të shoqërisë;



8. autorizon negocimin, perfundimin apo ndryshimin e cdo kontrate me afat ose per nje shume mbi dy milion leke ose ekuivalente ne valute (kufiri i kesaj shume caktohet per cdo vit).
9. kryhen te gjitha verifikimet qe cmon te nevojshme dhe ka te drejte te kerkoje te njihet me dokumentat e duhura per permbushjen e detyrave te tij (kurse ne cdo tre mujor nje raport te paraqitur nga drejtori i pergjithshem).
10. miraton bilancin vjetor e ia paraqet Asamblese se zakonshme,
11. miraton transferimin e aksioneve;
12. miraton praktikat e marketingut,
13. miraton strukturen e tarifave baze te sherbimeve,
14. therret dhe drejton mbledhjet e Asamblese,
15. disponon per transferimin e selise se shoqerise,
16. zgjedh drejtorin e pergjithshem (edhe drejtore te tjere) me votat e te pakten tre anetareve te keshillit Mbikqyres, nje nga te cilet duhet te jete Kryetari i Keshillit ;

#### NENI 15 DREJTORIA

Drejtoria eshte organ ekzekutiv i shoqerise. Ne periudhen fillestare te veprimtarise se shoqerise "TOP-OIL" SHA detyrat e Drejtorise i kryen vetem nje person i emeruar Drejtor i Pergjithshem.

Drejtori i Pergjithshem (sikurse edhe drejtoret) emerohet per nje periudhe tre vjecare. Ai mund te shkarkohet para afatit per paaftesi profesionale, ose per shkak te gjendjes shendetesore te semure qe e bent e paafta per plotesimin e detyres, ose per gabime te renda ne drejtimin e shoqerise.

Drejtori i Pergjithshem ( sikurse edhe drejtoret ) nuk mund te bejne pjese ne Keshillin Mbikqyres te shoqerise, por mund te jene aksionere net e. Menyra dhe masa e shperblimit te Drejtorit te pergjithshem (dhe e drejtoreve ne te ardhmen) caktohet nga Keshilli Mbikqyres qysh ne aktin e emerimit.

Drejtori i Pergjithshem eshte pergjegjes per drejtimin dhe mirefunksionimin e shoqerise si dhe per administrimin e pasurise se saj. Ai zbaton metodat dhe menyrat qe i cmon me te mira e me te pershtatshme per te realizuar detyrat e percaktuara nga Asambleja e Keshillit Mbikqyres.



Drejtori i pergjithshem ka kompetenca te plote per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te shoqerise, por kufizohet nga ato kompetenca qe ligji dhe ky statut ia ka dhene shpreshimisht keshillit Mbikqyres dhe Asamblese se Aksionereve.

Drejtori i Pergjithshem i ushtron kompetencat e veta brenda objektit te shoqerise. Ne marredhenie me te tretet ai perfaqeson shoqerine, e cila merr persiper detyrimet n ga aktet apo veprimet e perfunduara prej tij, kur keto jane te lidhura me objektin e shoqerise.

Te gjitha aktet dhe vendimet e Drejtorit te Pergjithshem firmosen, vulosen, protokollohen dhe ruhen ne arkiv. Drejtori i pergjithshem perdor vulen e shoqerise.

Ne fillim te veprimtarise se saj Drejtori i Pergjithshem i shoqerise "TOP-OIL" sha eshte z. Luan Saraçi.

Drejtori i Pergjithshem ka keto kompetenca ;

- propozon vendime e akte te tjera per Keshillin Mbikqyres ose Asamblene e Aksionereve.
- kerkon thirrjen e Asamblese se pergjithshme kur Keshilli Mbikqyres i refuzon autorizimin per nje operacion qe i lypset ky autorizim (sic jane operacionet qe parashikohen ne nenin 15 te ketij Statuti).
- emeron dhe shkarkon shefat e sektoreve dhe personelin tjeter administrative, si dhe percakton menyret dhe pagat e tyre,
- miraton kontraten tip te punes dhe kontraten tip me abonentet,
- merr vendime per marredheniet financiare brenda shoqerise dhe me personat e trete jashte saj,
- merr vendime per zgjidhjet teknike te rrjetit,
- autorizon shperblimet e vecanta e honoraret per punonjes te vecante te shoqerise ose persona te tjere jashte saj.

Ne cdo rast Drejtori i Pergjithshem eshte i detyruar qe, per veprimtarine e tij ne pergjithesi ose per probleme te vecanta, te raportoje ne Asamblene e aksionereve (kur kete e kerkojne aksionere qe zoterojne jo me pak se 1/5 e kapitalit te shoqerise) dhe ne Keshillin Mbikqyres ( kur kete e kerkojne kryetari ose jo me pak se tre anetare te ketij Keshilli).



Drejtori i pergjithshem ndihmohet ne aktivitetin e tij nga keshilli Operativ e Teknik.

Drejtori i Pergjithshem ka te drejte te delegoje pjese te kompetencave te tij.

#### NENI 16 KESHILLI OPERATIV – TEKNIK

Keshilli Operativ Teknik eshte organ konsultativ i Drejtorit te Pergjithshem net e cilin marrin pjese ky i fundit me cilesine e Kryetarit dhe keshilltaret e Shefat e Sektoreve, me cilesine e anetareve.

Keshilli Operativ Teknik mblidhet me kerkesen e Drejtorit te Pergjithshem ose te jome pak se dy anetareve te tij.

Keshilli Operativ Teknik nuk merr vendime, por i ben Drejtorit te Pergjithshem ne lidhje me problemet e drejtimit dhe administrimit te shoqerise, koordinimit te punes midis sektoreve, si dhe problemet e shfrytezimit te rrjetit ose te zgjerimit te tij.

Propozimet e ketij Keshilli miratohen me shumice votash.


Per anetaret e Keshillit Operativ – Teknik nuk parashikohet shperblim i vecante, pervec rasteve kur ata ngarkohen per te kryer studime e per te hartuar projekte qe tejkalojne detyrat e punes normale te tyre.

#### NENI 17

Mosmarveshjet e ndaluara dhe marveshjet qe kerkojne autorizim

Anetaret e Keshillit Mbikqyres dhe te Drejtorise ( Drejtori i Pergjithshem) u ndalohe te kontraktojne qe te marrin hua nga shoqeria, t'u akordohet llogari rrjedhese ose ne nje forme tjeter, dhe te bejne shoqerine dorezenese apo garante per detyrimet e tyre ndaj te treteve.

Cdo marveshje ndermjet shoqerise dhe njerit nga anetaret e keshillit Mbikqyres ose Drejtorise (Drejtori i Pergjithshem), qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi (me ndermjetesim), duhet te autorizohet paraprakisht nga Keshilli Mbikqyres (nga Kryetari apo jo me pak se tre anetare te ketij Keshilli).



**KONTABILITETI DHE FINANCAT E SHOQERISE**  
**NENI 18**

**AFTESIA PAGUESE**

Shoqeria "TOP-OIL" sha krijon marzhin e aftesise paguese te mjaftueshme per veprimtarine e saj, duke perfshire te gjithë vleren e pasurive, si kapitalin themeltar, rezervat, fitimet e mbartura etj.

**NENI 19**  
**USHTRIMI FINANCIAR**

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te cdo viti perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen dhe data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar deri ne 31 dhjetor.


**NENI 20**  
**BILANCI VJETOR**

Shoqeria do te mbaje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe veprimtarise se saj ne pajtim me kerkesat e ligjit. Per ndjekjen e gjendjes financiare Drejtori i Pergjithshem, sipas structures dhe permbajtjes se percaktuara ne planin kontabel, pergatit raportin mbi gjendjen financiare cdo tremujor si dhe ate vjetor.

Ne mbylljen e cdo viti financiar hartohet inventari i pasurise dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore per kontabilitetin, si dhe raporti vjetor mbi gjendjen financiare te shoqerise gjate ushtrimit te kaluar, ku parashikohen dhe ndryshime per te ardhmen e veprimtarite e tjera te shoqerise.

**NENI 21**  
**MIRATIMI I BILANCIT**

Raporti per gjendjen financiare te shoqerise i detajuar per te gjitha operacionet dhe per gjendjen e administrimit te shoqerise paraqitet nga Drejtori i pergjithshem ne fund te vitit financiar ne Keshillin Mbikqyres, i cili e miraton dhe ia paraqet Asamblese se zakonshme te aksionereve.



### EKSPERTET KONTABEL

Kontrolli financiar ushtrohet nga nje ose disa eksperte te autorizuar te licensuar conform legjislacionit shqiptar, te cilet emerohen nga Asambleja e zakonshme dhe kryejne misionin e tyre me pajtim me ligjin.

Ekspert kontabel nga aksioneri i vetem eshte emeruar z. Bashkim Kamberi.

### NENI 14

### E DREJTA E PERSONIT JURIDIK DHE DOKUMENTACIONI

Shoqeria TOP-OIL sha fiton te drejten e personit juridik qe nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne pergjithje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentet per krijimin e saj, Statutin dhe aktin e themelimit.

### AKSIONERET

LUAN SARAÇI      NIMET SARAÇI



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE

Nr. 662 Rep.  
Nr. 58 Kol.

### VERTETIM

Vertetohet se me date ~~20~~ 02.2004 para meje noteres u paraqit kerkuesit LUAN SARAÇI dhe NIMET SARAÇI per identitetin e te cileve u sigurova nga leternjoftimi perkates, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet deklaruan se akti i mesiperm eshte bere me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe nenshkruan para meje noteres dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

